



# **Monitorimi Lëndët për Duhanin në Divizionin e Kundërvajtjes në Gjykatat e Kosovës**

## **Duhani në Gjykatat e Kosovës**

**Kosovo Advocacy and Development Centre**

**Tetor 2017**

UCK No. 48/3 1  
10000 Prishtinë, Kosovë  
info@kadc-ks.org  
www.kadc-ks.org  
+377 44 188 366

## Falënderim

KADC falënderon të gjithë stafin gjyqësorë, administrativ dhe inspektoratin sanitar në komunat e Kosovës për gatishmërinë për ndarjen e të dhënave mbi numrin e lëndëve që ndodhen në procedura kundërvajtëse që kanë të bëjnë me shkeljen e ligjit për kontrollin e duhanit. Mbi bazën e këtyre të dhënave është bërë i mundur edhe realizimi i raportit monitorues mbi efikasitetin e procesimit të lëndëve të lartëpërmendura nga Gjykatat Themelore të Kosovës.

## Përmbajtja

Falënderim.....	2
Përmbajtja.....	3
Përmbledhja.....	4
Hyrja.....	6
Metodologjia.....	7
Monitorimi i Lëndëve për Duhan në Gjykatat e Republikës së Kosovës.....	8
Monitorimi në Nivel Vendi.....	8
Lëndët e Duhanit në Sistemin Gjyqësor të Kosovës.....	8
Vendimet e Gjykatave Themelore në Kosovë.....	9
Lëndët e Duhanit të Ndara në Regjione.....	12
Lëndët e Duhanit në Procedurë Kundërvajtëse Sipas Regjioneve.....	13
Shuma e Gjobave të Shqiptuara Sipas Regjioneve.....	14
Ligji i ri për Kundërvajte dhe Ligji për Kontrollin e Duhanit.....	15
Sfidat e trajtimit të Lëndëve për Duhanin në Gjykatat Themelore në Kosovë.....	16
Raportimi nga Inspektorët.....	17
Konkludimet.....	19

## Përmbledhja

Pas fillimit të zbatimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit, në maj të vitit 2013 dhe ndalimin 100% të pirjes së duhanit në hapësira të mbyllura, Kosova ka bërë edhe një hap më tutje në mbrojtje të shëndetit të qytetarëve.

KADC ka bërë monitorimin e lëndëve të duhanit në gjykata gjatë periudhës dy vjeçare shtator 2015 - 2017 me qëllim të përcjelljes së zbatueshmërisë së Ligjit për Kontrollin e Duhanit. KADC ka mbledhur të dhëna për lëndët e duhanit nga stafi gjyqësor dhe administrativ i gjykatave në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Të dhënat mbi të cilat ndërtohet raporti janë të dhëna në lidhje me numrin e lëndëve për duhanin të dorëzuara në gjykata nga inspektorati sanitar lokal dhe qendror.

Këto të dhëna janë marrë prej divizionit të kundërvajtjes në 7 gjykatat themelore dhe degëve që hyjnë në regjionin e tyre: në Prishtinë me degët: Gllogovc, Lipjan, Podujevë, (Graçanica është jo funksionale); në Mitrovicë me degët: Skenderaj, Vushtrri, (Leposaviqi dhe Zubin Potoku janë jo funksionale); në Pejë me degët: Klinë, Istog, Deqan; në Prizren me degët: Dragash, Suharekë; në Ferizaj me degët: Kaçanik, Shtërpce; në Gjilan me degët: Viti, Kamenicë, Novobërdë; dhe në Gjakovë me degët: Rahovec, Malishevë.

*Gjatë periudhës shtator 2015 - 2017, inspektorati sanitar në gjykatat e Republikës së Kosovës ka paraqitur gjithsej 321 lëndë të shkeljes së Ligjit për Kontrollin e Duhanit. Prej tyre, 177 lëndë janë të përfunduara, 144 lëndë janë ende në procedurë kundërvajtëse, 95 aktvendime janë lëshuar për personin përgjegjës, 34 aktvendime për personin fizik dhe 13 aktvendime për personin juridik. Në 1 rast gjykata ka lëshuar aktvendim për të dy palët - personin përgjegjës dhe personin juridik.*

Llojet e vendimeve të gjykatave të Kosovës, për lëndët e shkeljes së Ligjit për Kontrollin e Duhanit, janë të ndryshme: hudhjet, cedimet, pezullimet, lirim nga përgjegjësia, qortimet, mbikqyrja e shtuar e deri te gjoba. Aktvendimet dënuese më të shpeshta të gjykatave janë gjobat e shqiptuara për 144 lëndë, ndërsa qortimi dhe mbikqyrja e shtuar janë shqiptuar vetëm në 1 rast.

Gjykatat themelore në Kosovë nga inspektorati sanitar komunal kanë pranuar numër të ndryshëm të lëndëve për shkeljen e Ligjit. Gjykatat me më shumë lëndë të përfunduara janë ajo e Prizrenit, Pejës, Vitisë, Lipjanit, Kamenicës e Freizajt.

Monitorimi ka treguar që për zbatimin efikas të Ligjit për Kontrollin e Duhanit dhe sigurimin e mjediseve pa tym duhani, është i domosdoshëm trajnimi i autoriteteve inspektuese dhe zbatuese të procedurave kundërvajtëse, për zhvillimin e procedurave në përputhje me Ligjin.

Rritja e efikasitetit dhe shpejtësisë me të cilën procedohen lëndët e duhanit nëpër gjykatat e Kosovës, ndikon dukshëm në rritjen e zbatimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit.

Në bazë të të gjeturave nga monitorimi vlerësohet se forma më e mirë përmes së cilës mund të rritet efikasiteti i zbatimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit, është përmes lëshimit të gjobave mandatore nga ana e inspektoratit, porsa të jetë evidentuar shkelja

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Kundërvajtje në fillim të vitit 2017, procedura e kundërvajtjes anashkalon zhvillimin e procedurave në Gjykatë për gjobat fikse, gjobat deri në 500\$ për personin fizik, e deri në 1000\$ për personin juridik, dhe atyre të shqiptuara në vend. Neni 56 përshpejton procedurën burokratike të paraparë më herët për zgjidhjen e lëndëve për shkelje të ndalesave për duhan, duke mundësuar organin e kundërvajtjes të zhvilloj procedurën për gjobat mandatore në vend.

Në fund, është urgjente dhe i domosdoshëm trajnimi i inspektorëve qendror dhe lokal sanitar për zbatimin e procedurës kundërvajtëse sipas Ligjit të ri për Kundërvajtje i cili thjeshtëson procedurën dhe fuqizon sanksionet e parapara me Ligjin për Kontrollin e Duhanit.

## Hyrja

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Kontrollin e Duhanit në maj të vitit 2013 dhe ndalimin 100% të pirjes së duhanit në hapësira të mbyllura, Kosova ka përbushur edhe një obligim për integrim drejt Bashkimit Evropian. Ligji sanksionon dhe ngrit vetëdijen mbi rrezikun që i kanoset shëndetit të qytetarëve të saj nga duhan pirja pasive.

Edhe pse fillimi ishte premtues, zbatimi i ligjit është percjellë me sfida të shumta. Dy monitorimet e mëherëshme të KADC-së (njëri i përfunduar në fund të viti 2014, tjetri në fillim të 2015) për zbatimin e Ligjit për Kontrollin e Duhanit, kanë treguar se shkelësit më të mëdhenjë janë restorantet me 53.8%, kafenetë 71.6% dhe klubet natës 85.0%.

KADC në shtator të viti 2015 ka publikuar raportin "Duhani në Gjykatat e Kosovës", i cili monitoroi punën gjykatave për lëndët e duhanit. Raporti identifikoi problemet dhe sfidat në gjykata, me të dhënat mbi numrin e lëndëve për duhanin të dorëzuara në gjykata nga inspektorati sanitar prej hyrjes në fuqi të ligjit në maj të vitit 2013 deri në qershor të vitit 2015. Të gjeturat e raportit kanë treguar se për zbatim efikas të Ligjit për Kontrollin e Duhanit dhe sigurimin e mjediseve pa tym duhani është i domosdoshëm trajnimi i autoriteteve inspektuese në përpilimin dhe procedimin e lëndëve të duhanit, përditësimi i Ligjit për Kundërvajtje nga viti 1979 për t'i plotësuar nevojat e kohës dhe të shoqërisë, lëshimi i gjobave mandatore nga ana e inspektoratit dhe rritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve zbatuese të ligjit.

Raporti nga monitorimi i punës së gjykatave për vitin 2015 - 2017, është bërë që të identifikoj vazhdimësinë e zbatimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit, nga autoritetet zbatuese të tij. Identifikimi dhe percjellja e sfidave të gjykatave përgjatë procedimit të lëndëve kundërvajtëse do tu shërbej autoriteteve zbatuese të ligjit në përmirësimin dhe shpejtimin e procedurave vendimarrëse.

## Metodologjia

KADC nga fillimi i vitit 2017, ka filluar mbledhjen e të dhëna për lëndët e duhanit nga stafi gjyqësor dhe administrativ i gjykatave të shtrira në territorin e Republikës së Kosovës. Të dhënat mbi të cilat ndërtohet raporti janë të dhënat në lidhje me numrin e lëndëve për duhanin të dorëzuara në gjykata nga inspektorati sanitar prej shtatorit të vitit 2015 deri në shtator të vitit 2017.

Këto të dhëna janë marrë nga 7 gjykatat themelore në Kosovë dhe degët nën regjionin e tyre: në Prishtinë me degët Glllogovc, Lipjan, Podujevë, Gracanicë; në Mitrovicë me degët Skenderaj, Vushtrri, (Leposaviqi dhe Zubin Potoku janë jo funksionale); në Pejë me degët Klinë, Istog, Deqan; në Prizren me degët Dragash, Suharekë; në Ferizaj me degët Kaçanik, Shtërpce; në Gjilan me degët Viti, Kamenicë, Novobërdë; dhe në Gjakovë me degët Rahovec, Malishevë.

Të dhënat përmbajnë informata mbi numrin e lëndëve për duhanin që janë në procedurë kundërvajtëse, datën kur këto lëndë janë pranuar, datën kur janë marrë vendimet nga gjykata, vlerat e gjobave të cilat janë dhënë dhe për cilat subjekte janë lëshuar aktvendimet dënuese.

Gjatë këtij monitorimi janë bërë edhe intervista jo formale me gjyqtarë, për të parë anën e tyre dhe problemet të cilat ata i kanë identifikuar deri më tash, përgjatë rrugëtimit të tyre në zbatimin e këtij ligji në Kosovë.

## Monitorimi i Lëndëve për Duhan në Gjykatat e Republikës së Kosovës

### Monitorimi në Nivel Vendi

#### Lëndët e Duhanit në Sistemin Gjyqësor të Kosovës

Ligjit për Kontrollin e Duhanit në Kosovë hyri në fuqi në maj të vitit 2013 duke ndaluar 100% duhanpirjen në hapësira të mbyllura. Ligji i miratuar kishte për qëllim sanksionimin dhe ngritjen e vetëdijes, s mbi rrezikun që i kanoset shëndetit të qytetarëve nga duhan pirja pasive.

Nga monitorimi i punës së gjykatave të Republikës së Kosovës, gjatë periudhës shtator 2015 - 2017, për shkëljen e ligjit për duhan, janë paraqitur gjithsej 321 lëndë nga inspektorati sanitar qendror dhe komunal. Gjykatat themelore kanë përfunduar 177 lëndë duke dhënë vendime të plotëfuqishme, ndërsa 144 lëndë janë ende në procedurë kundërvajtëse.




Fig. 1. Numri total i lëndëve për duhan në Gjykatat Themelore të Kosovës, periudha shtator 2015 - 2017

Nga 177 vendime të gjykatave, 2 prej tyre janë apeluar në shkallën e dytë të sistemit gjyqësor në Kosovë. Dhe për të 2 rastet e paraqitura tek gjykata e apelit, vendimet janë vërtetuar edhe nga shkalla e dytë e sistemit gjyqësor në Kosovë. Kur kjo krahasohet me numrin e lëndëve për të cilat janë lëshuar aktvendime dënuesë në Kosovë, del të jetë një numër relativisht i vogël.






Fig. 2. Numri total i lëndëve për duhan, të apeluara në shkallën e dytë, periudha shtator 2015 - 2017

### Vendimet e Gjykatave Themelore në Kosovë

Aktvendimet e gjykatave në Kosovë, kanë qenë më të shpeshta për personin përgjegjës deri në 95 lëndë, për personin fizik numërohen 34 aktvendime, ndërsa për personin juridik numërohen vetëm 13 aktvendime. Dhe për 1 lëndë gjykatat kanë lëshuar aktvendime për të dy palët - personin përgjegjës dhe personin juridik.

Sipas dy monitorimeve të mëherëshme të KADC-së (njëri i përfunduar në fund të viti 2014, tjetri në fillim të 2015) për zbatimin e e Ligjit për Kontrollin e Duhanit, shkelësit më të mëdhenjë janë restorantet me 53.8%, kafenetë 71.6% dhe klubet natës me 85.0%. Pra monitorimet kanë treguar se shkelësit me të mëdhenjë janë personat juridik, e paradoksalisht në të dy monitorimet e KADC -së për punën e gjykatave mbi zbatueshmërinë të ligjit për duhan, për personat juridik ka më së paku aktvendime dënuese.




Fig. 3. Numri total i vendimeve të Gjykatave Themelore në Kosovë për personat fizik, përgjegjës dhe juridik, periudha shtator 2015 - 2017

### Vendimet e gjykatave themelore të lëshuara për personin: fizik, juridik & përgjegjës




Fig. 4. Numri total i vendimeve të Gjykatave Themelore në Kosovë për personat fizik, përgjegjës dhe juridik, periudha maj 2013 -2015

Llojet e vendimeve të gjykatave të Kosovës, për lëndët e shkeljes së ligjit për kontrollin e duhanit, janë të ndryshme siç shihen edhe në tabelën e mëposhtme. Ato variojnë nga: hudhjet, cedimet, pezullimet, lirim nga përgjegjësia, qortimet, mbikqyrja e shtuar e deri te gjoba. Aktvendimet dënuese më të shpeshta të gjykatave shihet se janë gjobat të shqiptuara në 144 lëndë, ndërsa qortimi dhe mbikqyrja e shtuar janë shqiptuar vetëm në 1 rast secila. Aktvendimet si pezullimi, hudhja e lëndës janë si rezultat i mungesës së fakteve relevante për të dëshmuar fajësinë e palëve në procedurë. Nga tabela e mëposhtme shihet se gjykatat në Kosovë inspektorati si palë nuk ka vërtetuar fajësinë e palës shkelëse të LKD-së në 26 lëndë, ose thënë me përqindje 14.6%.

Konflikti i kompetencave territoriale në mes të gjykatave për lëndët e duhanit është paraqitur me aktvendimin si cedim në 13 raste nga 177 të përfunduara, ose 7%. Parashkrimi i lëndëve për periudhën shtator 2015 - 2017, është më i ulët në 4 raste. Por kjo nuk e anashkalon rrezikun e parashkrimit të lëndëve të tjera, të cilat tashmë janë ende në procedurë. Më saktë ky rrezik u kanoset edhe 144 lëndëve të tjera, të cilat kanë mundësi të vjetërohen nga dita në ditë.




Fig. 5. Llojet e aktvendimeve të Gjykatave Themelore në Kosovë për shkeljen e Ligjit për Kontrollin e Duhanit, periudha shtator 2015 - 2017

Nga aktvendimet dënuese të shqiptuara në formë të gjobave për 114 lëndë, shihet se më shumë gjoba ka pasur në vlerë prej 50\$ dhe 500\$. Sipas ligjit për kontrollin e duhanit, gjobat në vlerë prej 50\$ lëshohen për persona fizik, gjobat në vlerë prej 500\$ lëshohen për personat përgjegjës dhe gjobat në vlerë prej 3000\$ janë gjoba që duhet të lëshohen për personat juridik. Pra siç shihet vlerat e gjobave të specifikuara nga LKD janë fikse. E megjithatë gjobat e lëshuara nga gjyqtarët, për shkeljen e ndalimit të pirjes së duhanit në hapësira të mbyllra, janë edhe në vlera prej 100\$ në 4 lëndë, 120\$ dhe 400\$ në 1 lëndë, 150\$ për 5 lëndë, 200\$ për 7 lëndë, 250\$ në 17 lëndë, 300\$ në 12 lëndë dhe 350\$ në 2 lëndë. Sipas gjyqtarëve kjo dukuri paraqitet pasi që LKD është ligj që zbatohet në kuadër të ligjit për kundërvajtje. Ligji për kundërvajtje ia njuh të drejtën gjyqtarëve që të vlerësojnë sipas bindjes së lirë gjobën e dhënë në përputhje me shkallën e fajësisë së personave dhe gjendjen e tyre ekonomike. Prandaj edhe rrjedhin gjobat, të cilat jo çdo herë janë në përputhje, me shumatat fikse të përcaktuara nga LKD.

Siç shihet edhe në figurën 3. gjobat të cilat janë shqiptuar më rrallë janë ato që u takojnë personave juridik. Përderisa në vendimet dënuese nga periudha maj 2013 -2015, vërehen gjoba për personat juridik në vlerë prej 1000\$, 1500\$ dhe 3000\$, kjo nuk ka ndodhur fare për periudhën shtator 2015 - 2017. Ku vendimet dënuese për personat juridik sipas vlerësimit të lirë të gjyqtarëve, për periudhën shtator 2015 - 2017, janë në të gjitha rastet në vlerë prej 500\$.

Gjyqtarët në Kosovë, me këto aktvendime kanë vlerësuar gjendjen ekonomike të personave përgjegjës dhe personave juridik, të njëjtë. Gjykatat në tërë Kosovën kanë dënuar personat juridik vetëm në 13 raste nga 321 të paraqitura për shkelje të LKD-së. Në të 13 lëndët si aktvendime dënuese ato kanë vendosur vlera shumë të vogla të dënimeve prej 500\$. Pra gjobat e shqiptuara nga gjykatat, për personat juridik sipas vlerësimit të lirë të gjyqtarëve në bazë të kriterit ekonomik, janë në përputhje me gjobat që shqiptohen për personat përgjegjës, në vlerë prej 500\$.




Fig. 6. Llojet e gjobave të shqiptuara nga Gjykatat Themelore, periudha shtator 2015 - 2017

## Lëndët e Duhanit të Ndara në Regjione

Gjykatat themelore, me më së shumti lëndë të pranuar nga inspektorati sanitar qëndror dhe lokal në krahasim me periudhën maj 2013 - 2015, janë gjykata themelore në Prizren me 100 lëndë, gjykata themelore në Prishtinë me 65 lëndë, gjykata themelore në Pejë me 25 lëndë, dega e gjykatës themelore në Viti me 24 lëndë dhe dega e gjykatës themelore në Suharekë me 14 lëndë.

Gjykatat të cilat kanë shënuar rënje, në krahasim me numrin e lëndëve të dërguara nga inspektorati përgjatë viteve 2013 - 2015, janë dega e gjykatës themelore në Lipjan, dhe gjykata themelore në Ferizaj, gjykata themelore në Gjiilan, dega e gjykatës themelore në Istog, Podujevë dhe Shtërpce.




Fig. 7. Numri total i lëndëve për duhan të ndara sipas Gjykatave Themelore të Kosovës, duke krahasua periudhën shtator 2015 - 2017 dhe maj 2013 - 2015

Gjykatat dhe degët e gjykatave ku inspektorati nuk ka dërguar lëndë për shkeljen e duhanit qysh nga viti i hyrjes në fuqi të Ligjit për Kontrollin e Duhanit janë ajo e Gllgovcit, Dragashit, Rahovecit, Klinës.

Ndërsa edhe sot e kësaj dite kemi dy degë të gjykatës themelore në Mitrovicë që janë jo funksionale, këto janë: dega e Leposaviqit dhe dega e Zubin Potokut, të cilave këtë periudh kohore i është bashkangjitur edhe dega e Graçanicës.

## Lëndët e Duhanit në Procedurë Kundërvajtëse Sipas Regjioneve

Gjykatat me më shumë lëndë të përfunduara përgjatë periudhës shtator 2015 - shtator 2017, janë ajo e Prizrenit, Pejës, Vitisë, Lipjanit, Kamenicës e Freizajt, siç mund të shihet edhe në figurën e mëposhtme.

Lëndët në procedurë janë ato lëndë për të cilat pritet të zhvillohet procedura në ditët në vijim, pra nuk ka aktvendim të lëshuar nga gjyqtarët. Numri i lëndëve në pritje për shkelje të ligjit për duhanit janë më të mëdha në gjykatën themelore në Prishtinë, në Prizren, në Malishevë dhe Suharekë.

Gjykatat me më shumë lëndë të ceduara, që shprehin konflikt të kompetencave territoriale, janë gjykatat e Vitisë, Prishtinë dhe Prizrenit. Cedimi i lëndëve nga gjyqtarët ndodh në rastet kur gjykata nuk ka kompetenca territoriale për të gjykuar rastin e paraqitur nga inspektorati sanitar i nivelit qendror.




Fig. 8. Lëndët e përfunduara dhe ato në procedurë për shkeljen e ligjit për duhan në Gjykatat Themelore të Kosovës, për periudhën shtator 2015 - 2017

Varësisht prej numrit të gjyqtarëve të cilët punojnë në këto gjykata, disa prej tyre kanë arritur të përfundojnë më shumë lëndë se të tjerat. Të dhënat tregojnë se jo domosdoshmërisht nevojitet numër i madh i gjyqtarëve për të përfunduar më shumë lëndë. Rast konkret për këtë është krahasimi i gjykatës së Prizrenit me 6 gjyqtarë që ka arritur të përfundojë 59 lëndë, gjykata e Pejës me 4 gjyqtarë që ka arritur të përfundojë 21 lëndë, ndërsa gjykata themelore e Prishtinës, ka përfunduar vetëm 7 lëndë edhe pse aty punojnë 10 gjyqtarë.

## Shuma e Gjobave të Shqiptuara Sipas Regjioneve

Vlera e shumës së gjobave të të gjitha gjykatat themelore të Kosovës, për shkelësit e Ligjit për Kontrollin e Duhanit gjatë periudhës shtator 2015 - 2017 është 24,020\$. Në krahasim me periudhën maj 2013 - 2015 vlera e gjobave të periudhës 2015 - 2017 është 11,330\$ më pak.




Fig. 9. Shuma e gjobave të Gjykatave Themelore për shkelësit e LKD-së, në periudhën shtator 2015 - 2017

Pas mbledhjes së shumës totale të gjobave të dhëna në formë sanksionesh, gjykatat që kanë pasur vlera më të larta të gjobave të lëshuara, ndaj shkelësive të LKD-së del të jenë: gjykata themelore e Prizrenit në vlerë prej 9,000\$, gjykata themelore në Pejë me shumë totale të gjobave në vlerë prej 3,750\$, gjykata themelore në Suharekë me 2,500\$ dhe ajo e Vitisë me 2,320\$.

Siç shihet në figurën 10, vlerat e shumës së gjobave ka qenë më të ulët në degën e Novobërdes dhe gjykatën themelore në Gjakovë.

## Ligji i ri për Kundërvajtje dhe Ligji për Kontrollin e Duhanit

Ligji i ri për Kundërvajtje ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2017. Ky ligj ka përditësuar ligjin e procedurës së kundërvajtjes që datonte qysh nga viti 1979.

Përditësimi i procedurës së kundërvajtjes ka eliminuar njëri nga sfidat e paraqitura në raportin e KADC -së mbi "Monitorimin e Lëndëve të Duhanit në Gjykatat e Kosovës".

Procedura e kundërvajtjes e përshkruar në Ligjin për Kundërvajtje të vitit 2017, anashkalon zhvillimin e procedurave në Gjykatë për gjobat fikse, gjobat deri në 500\$ për personin fizik, e deri në 1000\$ për personin juridik, dhe atyre të shqiptuara në vend, bazuar në "Nenin 56 Kompetenca e organit kundërvajtës pika (2) nga 2.1 - 2.4".

Neni 56 përshpejton procedurën burokratike të paraparë më herët për zgjidhjen e lëndëve për shkelje të ndalesave për duhan, duke mundësuar organin e kundërvajtjes të zhvillojë procedurën e gjobat mandatore në vend. Kjo do të rris efikasitetin e zbatimit të Ligjit për Duhan, pasi që sanksionet do shqiptohen në vend, ku edhe vërtetimi i fakteve do jetë i atypëratyshëm dhe ekonomik.

Procedura do zhvillohet në gjykata vetëm nëse sanksioni i gjobave nuk është fiks, gjoba është mbi 500\$ për personin fizik, ose mbi 1000\$ për personin juridik. Pasi që Ligji për Kontrollin e Duhanit ka paraparë gjoba fikse për personin fizik në vlerë prej 50\$, për personin përgjegjës në vlerë prej 500\$, aplikimi i nenit 56, të Ligjit për Kundërvajtje të vitit 2017, do të jetë shumë efikas dhe i lehtë.

Në aspektin ligjor raporti i KADC-së mbi "Monitorimin e Lëndëve të Duhanit në Gjykatat e Kosovës" kishte identifikuar si sfidë kohën e shkurtër të paraparë për parashkrimin (vjetërsimin) e lëndëve të cilat klasifikohen si kundërvajtje. Edhe Ligji i ri për Kundërvajtje, sipas "Nenit 42. Parashkrimi i zhvillimit të procedurës së kundërvajtjes" ka paraparë periudhë të njejtë për vjetërsim relativ dhe absolut të lëndëve në procedurë kundërvajtje. Vjetërsimi relativ aplikohet pas 1 viti, ndërsa ai absolut pas 2 vitesh. Megjithatë anashkalimi i procedurave në gjykata dhe rritja e vlerës së gjobave të atypëratyshme, që mund të shqiptohen nga e organit kundërvajtës, ka ulur rrezikun e parashkrimit të lëndëve të cilat do të zhvillohen nga ana e Organit të Kundërvajtës.

Megjithatë mbetet ende e paqartë se a do bëhet aplikimi i Ligjit të ri për Kundërvajtje për lëndët e duhanit të cilat janë regjistruar në gjykatë në periudhën kur aplikohet Ligji i Vjetër i Kundërvajtjes!

## Sfidat e trajtimit të Lëndëve për Duhanin në Gjykatat Themelore në Kosovë

Puna e gjykatave dhe përfundimi lëndëve për duhan, është në varësi të madhe me punën e inspektoratit, policisë dhe palëve shkelëse të ligjit.

Numri i lëndëve të përfunduara është në përpjestim të drejtë me numri i gjyqtarëve që punojnë në divizionin e kundërvajtjes. Në raportin e KADC -së "Monitorimi i Lëndëve të Duhanit në Gjykatat e Kosovës" është vërejtur se numri i madh i lëndëve në procedurë paraqitet: kur numri i vogël i gjyqtarëve ballafaqohen me numrin e madh të lëndëve që janë pjesë e juridiksionit të gjykatës kundërvajtëse.

Monitorimi ka treguar se aktvendimet dënuese të gjykatave për shkelje të Ligjit për Kontrollin e Duhanit, kanë qënë në numër të vogël për personat juridik. Në dy monitorimet mbi "Zbatueshmërinë e Ligjit për Kontrollin e Duhanit" të KADC-së (njëri i përfunduar në fund të viti 2014, tjetri në fillim të vitit 2015), shkelësit më të mëdhenjë janë restorantet me 53.8%, kafenetë 71.6% dhe klubet natës me 85.0%. Pra shkelësit me të mëdhenjë të ligjit janë personat juridik. E megjithatë gjykatat kanë vetëm 13 aktvendime dënuese për personat juridik, përgjatë periudhës shtator 2015 - 2017.

Ligji për Kontrollin e Duhanit siç shtë shpjeguar edhe më lartë, zbatohet në kuadër të Ligjit për Kundërvajtje. Ligji për Kundërvajtje ia njeh të drejtën gjyqtarëve që të vlerësojnë sipas bindjes së lirë gjobën për kundërvajtësit. Vlerësimi sipas bindjes së lirë bëhet në përputhje me shkallën e fajësisë së personave dhe gjendjes së tyre ekonomike.

Përgjatë monitorimit është vërejtur se edhe pse ka pasur pak aktvendime dënuese për personat juridik, ato aktvendime kanë qënë të gjobave në vlerë prej 500\$. Vendimet dënuese për personat juridik për periudhën shtator 2015 - 2017, janë në të gjitha rastet në vlerë prej 500\$. Ndërsa në periudhën maj 2013 - 2015, ka pasur gjoba në vlerë prej 3000\$ për personat juridik. Bindja e lirë e gjyqtarëve, sipas kriterit ekonomik ka barazuar mundësinë e pagesës së gjobës, në mes të personave juridik dhe përgjegjës.

Sfidë e gjyqtarëve vazhdon të mbetet përcaktimi i përgjegjësisë së personit juridik dhe personait përgjegjës. Ndarjes së këtyre dy përgjegjësave, ku fillon njëra dhe ku mbaron tjetra.

Parashkrimi dhe vonesat me lëndët për duhan, sipas informatave joformale nga gjyqtarët, kanë ndodhur si rezultat i pamundësisë së sigurimit të prezencë të të pandehurit. Urdhëresat për sigurimin e të pandehurit në seanc, nga ana e policisë nuk zbatohen me kohë. E njëjta vlen edhe për inspektoratin, kur u kërkohet që të përplotësojnë lëndën me fakte të tjera shtes.



Interaksioni i vogël me media nga ana e gjykatave, në lajmërimin e rasteve të dënimit të palëve shkelëse, ka paraqitur pengesë në krijimin e përshtypjes së shkelja e ligjit dënohet.

## Raportimi nga Inspektorët

Mënyra e raportimit të shkeljes së Ligjit për Kontrollin e Duhanit, ka mangësi nga vetë inspektorët.

Kërkesat për iniciimin e procedurës për kundërvajtje nga ana e inspektorëve janë të mangëta nga provat, duke e bazuar lëndën tek përgjegjësia objektive e palëve. Përfshirja e përgjegjësisë objektive në hartimin e lëndëve, nuk pranohet si bazë e fajit nga gjyqtarët.

Vështirësi vazhdon të mbetet paqartësia për provat që duhet të paraqiten para gjykatës, në mënyrë që ato të jenë të besueshme. Paqartësi ka edhe mbi kornizën e përgjegjësisë të personit juridik dhe përgjegjës. Kur përmbushet detyra e personit juridik e kur detyra e personit përgjegjës.

Në vazhdim do të paraqesim se cilat prova konsiderohen si të domosdoshme për të qenë një lëndë e suksesshme në konstatimin e shkeljes së Ligjit për Kontrollin e Duhanit:

1. Prej momentit kur inspektori hyn në lokal, duhet të inspektojë se a janë në vende të dukshme shenjat që e ndalojnë pirjen e duhanit;
2. A ndodhen taketuket në tavolina;
3. Klientët që janë gjetur duke pirë duhan të ju shqiptohet gjoba mandatore në vend të ngjarjes;
4. Të identifikohen klientët që kanë bërë shkelje duke ju marrë numri i ID kartelës, adresa e saktë;
5. Kur është e mundshme të bëhet fotografimi i lokalit gjegjësisht vendit të ngjarjes. Në foto duhet të shihet data kur është bërë ajo, vendi përreth që të mund të identifikohet lokali ose vendi ku është bërë shkelja);
6. Inspektori të nxjerrë listën e thirrjeve telefonike në numrin pa pagesë për atë ditë në të cilën pala deklaron se e ka bërë thirrjen si dhe ta marrë numrin e palës për të vërtetuar këtë gjë.

Inspektorati nuk përcjell lëndët të cilat i ka inicuar në gjykatë, për shkelje të duhanit. Prandaj ndodh parashkrimi ose vjetërsimi i lëndëve. Por inspektorati përpos që nuk përcjell lëndët, si organ zyrtar nuk u përgjigjet shpesh edhe thirrjeve të gjyktave, për plotësimin e lëndës me fakte shtesë.

Përpos parashkrimit, që paraqitet si rezultat i mospërcjelljes së lëndëve nga ana e inspektorëve, është vërejtur edhe një trend i rritjes së lëndëve të ceduara. Lëndët e ceduara janë ato të cilat parshtruesi i ka dërguar gabimisht në gjykatë, e cila nuk ka kompetenc territoriale.

Inspektorët sipas Ligjit të ri për Kundërvajtje, Neni 56 "Kompetencat e Organit Kundërvajtës", do të kenë mundësinë e dhënjes së gjobave mandatore deri në vlerë prej 500\$ për personin fizik, dhe 1000\$ për personin juridik. Por zbatimi i këtij neni, mbetet të shihet pasi që edhe në monitorimet e kaluara inspektorët kanë hezituuar në aplikimin e gjobave mandatore.

## Konkludimet

Forma përmes së cilës do të rritet efikasiteti i zbatimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit, siç është vërejtur edhe në raportin "Duhanit në Gjykatat e Kosovës", është ajo e lëshimit të gjobave mandatore nga ana e inspektoratit, porsa të jetë evidentuar shkelja.

Gjobat mandatore anashkalojnë procedurën kundërvajtëse, por në të njëjtën kohë u japin palëve kohë për të mbrojtur të drejta e tyre nëse ato janë shkelur. Kjo është arsyeja pse shqiptimi i gjobave nga inspektorati, është forma më e mirë dhe më të shpejtë për të rritur zbatimin e Ligjit për Kontrollin e Duhanit në Kosovë.

Ligji për Kundërvajtje, i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2017, thekson se gjobat mund të shqiptohen atypëraty nga organi i kundërvajtjes, në shumën e caktuar saktë, deri në 500\$ për personin fizik dhe 1000\$ për personin juridik. Ligji specifikon që në rastet e lartë përmendura, gjykata nuk zhvillon procedurë edhe nëse pala parashtron ankesë për gjobë edhe kur nuk paguan gjobën brenda afatit kohor. Nëse nuk paguhet gjoba brenda afatit kohor, atëher zbatohet përmbarimi i detyrueshëm, i bazuar në Ligjin për Përmbarim, nenin 30.4. E në rastet kur ushtrohet e drejta për kundërshtim brenda afatit kohor, procedura zhvillohet para organit të kundërvajtjes, si shkallë e dytë, Ligji për Kundërvajtje neni 60.1.

Sipas të dhënave të marra nga gjykatat për lëndët e duhanit, vërehet se gjobat e deritanishme të shqiptuara përgjatë vitit 2015 - 2017, në asnjë rast nuk kanë kaluar vlerën prej 500\$, madje edhe për personat juridik. Prandaj zbatimi i Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L.087, për zhvillimin e procedurës pranë organit të kundërvajtjes duke anashkaluar procedurat në gjykata do të jetë mjaft i përshtatshëm. Inspektorati ka të drejtë të shqiptoj gjoba porsa të jetë evidentuar shkelja e Ligjit për Kontrollin e Duhanit. E kur ushtrohet e drejta për ankes nga pala, prap procedura për gjobat e shqiptuara do zhvillohet tek organi kundërvajtës si shkallë e dytë. Me zbatimin e ligjit të ri për kundërvajtje, zhvillimi procedurave të kundërvajtjes do t'i anashkalojë procedurat burokratike në gjykatë, parashkrimin si vjetërsim i lëndës, cedimin si konflikt i kompetencës territoriale, problemet administrative si numri i vogël i gjyqtarëve, e numri i madh i lëndëve të ndryshme të cilat duhet ti përfundojnë gjyqtarët e njejtë.

Ndërsa për lëndët të cilat janë paraqitur në gjykata para hyrjes në fuqi të Ligjit për Kundërvajtje, dhe për ato të cilat edhe me Ligjin për Kundërvajtje, Nr. 05/L.087 parashihet procedura në gjykatë, rekomandohet që lëndët të përcillen nga inspektorati edhe pas dorëzimit, inspektorati të përgjigjet me kohë në pyetjet e gjykatës, sjellja e palës në procedurë të përshpejtohet me bashkëpunim me policinë ose të vendoset lënda edhe në mungesë të palës së papërgjegjshme, sipas nenit 200 të Ligjit për Kundërvajtje të vitit 1979 për lëndët që ende zbatohet ky ligj, dhe zbatimi i nenit. 95 pika 4 - 5 "Thirrja e të Pandehurit" tek lëndët e reja për të cilat mund të zbatohet Ligji Nr.

05/L.087. Neni 200. i Ligjit për Kundërvajtje të vitit 1979 dhe neni 95 pika 4-5 i ligjit të ri për kundërvajtje parasheh marrjen e aktvendimit pa marrjen në pyetje të palës së papërgjegjshme, e cila me qëllim e eviton paraqitjen në gjykatë.

Për lëndët të cilat procedohen në gjykatë, Inspektori ka obligim që lëndën e porsa përpuar ta dorëzojë pa humbur kohë, pasi që koha e parashkrimit fillon të ecë prej momentit kur është evidentuar shkelja.

Konkludohet se duhet të rritet numri i gjobave për personat juridik. Në monitorimet e KADC-së për "Zbatueshmërinë e Ligjit për Kontrollin e Duhanit në Kosovë", personat juridik kanë qenë shkelësit më të mëdhenjë të LKD-së. Ndërs tendenca e gjykatave, prej hyrjes në fuqi të Ligjit për Kontrollin e Duhanit, ka qenë dënimi i personave përgjegjës. Nga moniorimi "Duhani në Gjykatat e Kosovës" është vërejtur se në shumicën e rasteve personi përgjegjës është konsideruar fajtor për shkeljen e LKD-së nga pronarët, në mënyrë që t'i largohen gjobave në vlera 3 shifrore të parapara nga LKD për personat juridik.

Aktvendimet dënuese me gjoba për shkeljen e Ligjit për Kontrollin e Duhanit, kur gjoba shqiptohet sipas bindjes së lirë të gjyqtarit, rekomandohet të jenë në përputhje me kriterin ekonomik të personave juridik. Gjobat e shqiptuar përgjatë periudhës shtator 2015 - 2017, për personat juridik kanë qenë në vlerë prej 500\$. Bindja e lirë e gjyqtarëve, sipas kriterit ekonomik ka barazuar mundësinë e pagesës së gjobës në mes të personave juridik dhe përgjegjës.

Në bazë të këtij raporti gjithashtu rekomandohet trajnimi i inspektorëve, në procedimin dhe hartimin e lëndëve të cilat janë të pranushme nga gjyqtarët. Dhe trajnimi i gjyqtarëve e inspektorëve për të eliminuar paqartësit dhe interpretimet e ndryshme përreth përgjegjësisë objektive, subjektive të personave juridik, përgjegjës dhe subjekteve afariste.